

BAÇELOR
DEPARTAMENTI I GAZETARISË
PROGRAMI I STUDIMEVE: GAZETARI
SILABUSI I LËNDËS: EDUKIMI MEDIAL

1. Titulli i lëndës: Edukim medial

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Titulli i lëndës:	Edukim medial
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i tretë, Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	8
Koha / Vendi:	Ligjërata: Ushtrime:
Mësimdhënësi:	Prof.Asst.Dr. Muhamet JAHIRI Asistneti: MA Blerta Dibrani
Të dhënat kontaktuese:	Email: muhamet.jahiri@uni-pr.edu , blerta.dibrani@uni-pr.edu Tel: +383(0)38222970
Përshkrimi i lëndës:	Edukimi për media është një analizë e informatave, vlerave, dhe mesazheve të nënkuptuara që i përçojnë mediat, përfshirë gazetatat, portalet, mediet e reja, televizionin, internetin, revistat, radion, filmin, etj. Në këtë lëndë shqyrtohet saktësia e këtyre mesazheve dhe mënyra se si mediat, përfshirë dhe reklama dhe lojërat elektronike, e konstruktojnë pikëpamjen tonë për politikën, kulturën dhe shoqërinë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e kësaj lënde janë që të nxisë të menduarit kritik tek studentët në mënyrë që ata të kuptojnë se si mediat masive ndikojnë në jetën dhe në pikëpamjet tona. Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë rolin dhe strategjitë e mediave masive në konstruktimin e proceseve shoqërore, kulturore dhe politike. Studentët do të analizojnë lloje të ndryshme të medias përfshirë imazhe, video, lojëra dhe internet. Ata do të krijojnë aftësi të edukimit mediatik që do t'u mundësojnë vetëdijesim gjatë të nxënës gjatë gjithë jetës. Studentët bashkërisht me mësimdhënësin do ta përgatisin shtojcën për ditën e shtypit të lirë, 3 majin.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas mbarimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të: • Kuptojnë dhe përdorin koncepte dhe terminologji të edukimit për media • Analizojnë paragjykime, stereotipe, të dhëna dhe informacione në mediat masive • Jenë të vetëdijshëm për llojllojshmërinë e mesazheve në media dhe mënyrën e prezantimit të njerëzve, ngjarjeve dhe ideve në raport me prodhuesit e mesazheve • Analizojnë strukturën, përmbajtjen dhe qëllimet e medias si dhe efektin e tyre në shoqëri , kulturë, ekonomi, dhe politikë • Shfrytëzojnë shkathtësitë e tyre të edukimit mediatik për të përdorur mediat në mënyrë kreative dhe interaktive
-----------------------------------	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike	2	15	30
Përgatitje për test intermediar	15	1	15
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	8	2	16
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			209.5 orë

Metodat e mësimdhënies:	Studentët janë të obliguar t'i lexojnë materialet përkatëse para orës. Mësimdhënia dhe mësimnxënia nuk do të shihen të ndara preraz, sipas procedurave rigjide, por do të jenë vazhdimisht të ndërlydhura me njëra tjetrën, si marrje dhe dhënie e ndërsjellë, që i ofrojnë mundësi secilit student të marrë pjesë në këtë proces dhe të japë kontributin personal në prodhimin e vazhdueshëm të dijes.
Metodat e vlerësimit:	Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive 10 për qind Prezantimi/Hulumtimi dhe kontributet tjera në klasë 30 për qind Testi 20 për qind Asistentja 40 për qind

Literatura primare:	Potter,James, Media Literacy,Sage Publications, 6th Ed. Buckingham, David, Media Education, Cambrige Lindita Tahiri, Komunikimi masiv dhe edukimi për media David Buckingham, “Media Education: Literacy, Learning and Contemporary Culture”, 2003, Polity Press Henry Jenkins, “Convergence Culture: Where Old and New Media Collide”, 2006, New York University Press Dan Anderson, “Critical Media Literacy: Teaching and Learning Beyond the Textbook”, 2007, Routledge Shannon L. McMahon, “Teaching Media Literacy in the Classroom, 2010, National Council of Teachers of English Vivian Maria Vasquez, “The Media and Literacy: A Guide for Teachers”, 2014, Routledge
Literatura shitesë:	Macedo,Donaldo and Steinberg Shirledy (editors), Media Literacy,2008 Rosa Joao and Rosa Ricardo, Pedagogy in the age of Media Control, NY, 2011 Jackson, Brooks and Hall Jamieson, Kathleen unSpun- finding facts in a world of [disinformation], NY,2007 Hoeschmann, Michael and Poyntz Stuart, Media Literacies, Blackwell Publishing 2012 Barber, Benjamin, Consumed, NY 2008. Buckingham, David ,The material child,Cambridge 2011 Baker, Elizabeth, The New Literacies, NY, 2011 Brummett, Barry,Rhetoric in Popular Culture,Sage Publications, 2011 Asa Berger, Arthur, The Objects of Affection, NY 2010 Mihailidis, Paul,editor, News Literacy, NY,2012 Zengotita, Thomas, Mediated, NY 2005 Tyner, Kathleen. Media Literacy, Routledge publishing,2010 Silverblatt, Art, Media Literacy, London 2008 Potter, W, James. Theory of Media Literacy, Sage publications, 2004.

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njohje me lëndën
Java 2:	Konteksti i ri i komunikimit dhe nevoja e edukimit për media
Java 3:	Shkathhtësitë e edukimit për media
Java 4:	Perspektiva e individuale dhe industriale e publikut.
Java 5:	Përmbajta mediatike dhe realiteti
Java 6:	Lajmet si realitet i konstruktuar. Objektiviteti dhe formulat e rrëfimeve lajmore. Analiza e perspektivës rrëfyese lajmore
Java 7:	Reklama. Lojërat elektronike
Java 8:	Formulat e argëtimit. Përsëritje e kapitullit.
Java 9:	Edukimi kritik dhe shkolla
Java 10:	Koncepti i kornizës. Kornizimi pozitiv i mediave të reja

Java 11:	Efektet e manifestuara dhe efektet e procesit
Java 12:	Shkathhtësitë dhe vlerat personale.
Java 13:	Çështjet kundërthënëse në studimin e medias
Java 14:	Prezantim i punimeve për shtojcën e ditës të shtypit të lirë
Java 15:	Në mbarim të këtij kursi, a mendoni se jeni vetëdijesuar më shumë për mesazhet e mediave dhe mund t'i kontrolloni ato ashtu si dhe strukturat e njohurive dhe ndikimet të cilat i keni prej tyre ?Si do t'i shfrytëzonit këto shkathhtësi të reja për t'u ndihmuar të tjerëve ta zhvillojnë edukimin për media? Shembuj konkret. Finalizim i shtojcës.
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes	
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: Standard	